

## **STATUT I SHOQËRISË**

### **“ BAKUS “ SHPK**

Ne Tirane, sot me date 12/01/2022 unë Z.Laert Gjergji, i biri i Baki, datelindjes 09.04.1990, lindur ne Gjirokaster dhe banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, mbajte i leternjoftimit me nr. Personal J00409051R ne cilesine e “ortakut themelues“ deklaroj se me vullnet të lire të plote e të sinqerte, dhe inisiativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, “ Per tregtaret dhe shoqerite tregtare “, ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 “ Per Qendren Kombetare te Regjistrimit “, ne ate Doganor, Fiskal e Tatimor, hartoj statutin e shoqerise “ **BAKUS “ SHPK**

#### **KREU I**

##### **Neni 1 Krijimi**

Shoqëria “ **BAKUS “ SHPK** , është person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur “Shoqeria”).

##### **Neni 2 Personaliteti juridik**

Shoqeria ka fituar personalitetin juridik me regjistrimin e saj ne Organet Kompetente, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria “ **BAKUS “ SHPK** , është një shoqëri tregtare, e themeluar nga **Z.Laert Gjergji**, i cili nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributi i ortakut përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

Ortaku gëzon kuotën e tij në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që ka dhënë në kapital.

##### **Neni 3 Selia**

Shoqëria e ka selinë ne adresën Fshati Rade, Bashkia Manez Durres . Shoqeria mund te ndryshoje seline e tij, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojte filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me vendim te Ortakut te Vetëm.

##### **Neni 4- Objekti i veprimtarise**

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte si me poshte:



Kultivimin e tokave bujqesore, ne pronesi te shoqerise ose te poseduara nga shoqeria, pavaresisht titullit te posedimit, prodhimin e veres (vitikultura), mbjelljen dhe rritjen e pemrave (silvikultura), mbareshtimin e kafsheve dhe vecanerisht bagetive dhe pulave; si dhe kryerjen e cdo veprimtarie qe lidhet manipulimin, ruajtjen, transformimin dhe tregtimin e produkteve te shoqerise ose cdo pale te treta, qe kane si objekt produktet e perftuara kryesisht nga bujqesia, pemtaria ose blegtoria, si edhe cdo veprimtari qe lidhet me furnizimin e mallrave ose sherbimeve kryesisht nepermjet perdorimit te pajisjeve ose burimeve te shoqerise qe zakonisht perdoren per kryerjen e veprimtarive bujqesore apo blegtoral. Podhimin dhe tregtimin, ne cdo lloj forme, te veres, vermutit, veres se gazuar, si dhe cdo produkti tjetër qe merret nga perpunimi i rrushit, i veres si dhe i derivateve te tyre. Kryerjen e ambalazhimit, etiketimit dhe futjen ne shishe te produkteve te mesiperme, per llogari te saj ose te paleve te treta. Kryerjen e veprimtarive te nenkontraktuesit te rrushit, veres dhe derivateve te tyre. Kryerjen e analizave kimike, fizike, mikrobiologjike e ndjesore te vererave dhe/ose produkteve te tjera ushqimore. Keshillimin legjislativ, teknik dhe administrativ ne fushen e prodhimit te veres, rritjes se rrushit, bujqesise si dhe cdo fushe tjetër te lidhur me to; trajnimin dhe pergatitjen e eksperteve bujqesore dhe enologjik. Marrjen me qira, administrimin dhe ose 2 marrjen me koncesion te shoqerive te ketij sektori apo dhe sektoreve te tjera te lidhur me te, te tilla si prodhimi dhe administrimi i ushqimeve dhe/ose pijeve, apo turizmi. Ne perputhje me legjislacionin shqiptar, ne menyre qe te arrihet qellimi i siperpermendur, Shoqeria ka te drejte: te mundesoje trajnime profesionale per punemarresit e saj apo pale te treta. Te kryeje cdo transakcion ne lidhje me pasurite e luajtshme dhe te paluajtshme, si dhe cdo aktivitet tregtar, financiar dhe industrial, dhenie-marrje me qira, te vendose pengje dhe barre hipotekare qe mund te konsiderohen si te dobishme apo te nevojshme per te arritur qellimet e Shoqerise. Te kryeje cdo aktivitet ne lidhje me publikimin, marketingun apo reklamimin. Te zoteroje kuota/aksione apo cdo lloj interesi tjetër ne shoqeri te tjera, pavaresisht fushes ne te cilen kryejne veprimtari keto shoqeri. Shoqeria kryen cdo lloj aktiviteti qe ben pjese ne objektin e saj, qe lidhet me te dhe qe e favorizon ate.

#### **Neni 5- Kohezgjatja**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij per nje periudhe kohore pa afat.

## **KREU II KAPITALI**

### **Neni 6- Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 1.000 (njemije) Lekë. Kapitali i mesiperme eshte nënshkruar nga "ortaku i vetem" i shoqerise **Z.Laert Gjergji**, dhe perbet nga 1 (nje) pjese/kuote me vlere te pergjithshme 1.000 (njemije) Leke, qe perben 100 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme. Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta) .

Ortaku pergjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te tretteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

### **Neni 7- Zmadhimi dhe zvogelimi I kapitalit**



Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë.

Zvogëlimi dhe zmadhimi i kapitalit realizohet me vendim të Ortakut të Vetem në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

## **Neni 8 Kuotat**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Transferimi i kuotave të të tretet kufizohet me miratim të asamblese së ortakut në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

## **KREU II ORGANET DREJTUESE DHE VENDIMMARRESE**

### **Neni 9**

#### **Organi Vendimmarres**

Ortaku i Vetem është organi i vetem vendimmarres i shoqërisë.


Ortaku i Vetem është organi vendimmarres i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të percaktuara në ligj. Çdo ndryshim i statutit duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

*Ortaku i vetem, vendos për çështje si :*

- a. përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b. emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c. emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d. mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e. përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Të gjitha vendimet e marra nga ortakut i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;



- b. shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
  - c. investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

### **Neni 10 – Administrimi**

Shoqëria administrohet nga Administratori i cili caktohet ne statutin e shoqërisë dhe me pas nga Asambleja e Ortakeve. Administratori qëndron ne detyre për një periudhe kohore prej 5 vjet dhe ne rast se gjate kesaj periudhe shfaqen probleme paaftësie nga ana e secilit prej tyre, Asambleja e Ortakeve vendos shkarkimin e administratorit duke treguar me fakte demin qe i është shkaktuar shoqërisë nga paaftësia e tij pasi eshte dhënë mendimi per kete dem edhe nga specialistet përkatës.

Administratori ka te gjithë kompetencat per te vepruar me te tretet ne emer te shoqerise dhe ne interes te saj ne te gjitha rrethanat me përjashtim te kompetencave qe ligji dhe Statuti i shoqërisë u'a jep shprehimisht ortakeve.

Administratori ka të drejte që të gjitha kompetencat e përmendura me sipër t'i ushtrojnë se bashku apo vec e vec duke qene pergjegjes individualisht ose solidarisht, sipas rastit, ndaj shoqërisë apo te treteve, për shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqërisë.

Ata nuk mund te marrin vendime te rëndësishme siç janë huate, te shesin pronat e shoqërisë, apo te bëhen dorëzanes ne emer te saj. Ata nuk mund te kryejne veprime te cilat i lihen ne kompetence Asamblesë se Ortakeve.

Asambleja mund te vendose lejimin e nje shpërblimi ne favor te Administratorit per kryerjen e detyrës përveç pagimit te shpenzimeve.

#### **Administrator i shoqerise eshte:**

- **Z.Laert Gjergji**, i biri i Baki,i datelindjes 09.04.1990, lindur ne Gjirokaster dhe banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, mbajte i leternjofimit me nr. Personal J00409051R

Administratori emerohet per nje afat 5 (pese) vjecar, gjithashtu mund te shkarkohet dhe riemertohet me vendim te Ortakut te Vetem te Shoqerise.

### **Neni 11 - Kompetencat**

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a. kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b. përfaqësojë shoqërinë tregtare;



c. kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

d. përgatis dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;

e. krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

f. kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

g. raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori është i detyruar të thërrasi mbledhjen e ortakut të vetem edhe në rastet kur:

a. sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe

b. kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Administratori ka të drejte të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakut të shoqërisë.


Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

## Neni 12 Pergjegjesite

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Ortaku i Vetem që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.



Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:

- a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;
- d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;

ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

- d) jep kredi.


### **Neni 13 Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor.

### **Neni14 Balanci i shoqerise dhe dividendet**

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Ortakut te Vetem, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Ortakut te Vetem vendos rreth shperndarjes se dividendit, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.



## Neni 15 Ekspertet

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakut të vetëm. Në përfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar përfaqëson raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultetit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakut për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

## Neni 16

Të ardhurat neto ( Dividenti ) që mbeten pas vecimit të fondeve ligjore të mesiperme dhe të atyre për shlyerjen e çdo detyrimi fiskal apo likuidimit të pagesave ndaj të tregtarëve, i mbeten dhe i kalojnë në pronësi, ortakut të vetëm të shoqërisë.

## Neni 17

*Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë :*

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të ortakut të vetëm;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) me vendim të gjykatës;

Në këtë rast Ortaku i Vetëm merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaku i Vetëm.

Nëse Ortaku i Vetëm nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

## Neni 18

Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij.

Nëse shoqëria emëron më shumë se një likuidues, përveçse kur akti i emërimit parashikon se ata veprojnë veçmas njëri-tjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkërisht të drejtat e detyrimet sipas këtij ligji.


Likuiduesit mund të autorizojnë njërin prej tyre të kryejë veprime të një kategorie të posaçme.

Kufizimet e tagrave të likuiduesve u kundrejtohen të tretëve, në përputhje me përcaktimet e ligjit.

Likuiduesi u nënshtrohet mbikëqyrjes së ortakut dhe administratorit.

## Neni 19

### Të drejtat e detyrimet e likuiduesit



1. Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil.

2. Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar.

3. Nëse, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, sipas nenit 194 të ligjit “ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare “, likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit e t’i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.

Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet në shoqërinë kolektive dhe komandite miratohen nga ortakët e tjerë, ndërsa në shoqëritë aksionare apo nga ato me përgjegjësi të kufizuar miratohen nga asambleja e përgjithshme.

#### **Neni 20**

#### **Përfundimi i likuidimit**

Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Regjistrimit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë, në përputhje me seksionin V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

#### **Neni 21**

#### **Bashkimi**

Dy ose më shumë shoqëri mund të bashkohen nëpërmjet:

1. Kalimit të të gjitha aktiveve e pasiveve të njëres ose më shumë prej shoqërive, që quhen shoqëritë e përthithura, të një shoqëri tjetër ekzistuese, e quajtur shoqëria përthithëse, në këmbim të aksioneve apo kuotave të kësaj shoqërie. Ky proces quhet bashkim me përthithje.

2. Themelimit të një shoqërie të re, tek e cila kalohen të gjitha aktivet e pasivet e shoqërive ekzistuese, që bashkohen në këmbim të aksioneve apo kuotave të shoqërisë së re. Ky proces quhet bashkim me krijim i një shoqërie të re.

#### **Neni 22**

#### **Ndarja**

Një shoqëri mund të ndahet me vendim të Ortakut të Vetem, duke transferuar të gjitha aktivet e pasivet e veta në favor të dy ose më shumë shoqërive ekzistuese apo të themeluara rishtazi. Shoqëria që ndahet, vlerësohet e prishur.

Për ndarjen e shoqërisë zbatohen përkatësisht dispozitat e neneve 216 deri në 225 të ligjit 9901 date 14.04.2008.

Shoqëritë, që fitojnë pasuritë e shoqërisë që ndahet, quhen shoqëri pritëse dhe përgjigjen në mënyrë solidare për detyrimet e kësaj të fundit.

Regjistrimi i ndarjes së shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit ka si pasojë:





- a. kalimin te shoqëritë pritëse të të gjitha aktiveve e pasiveve të shoqërisë që ndahet, në përputhje me raportin e ndarjes, të përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes. Ky kalim sjell pasoja për marrëdhëniet ndërmjet shoqërive, si dhe për palët e treta
- b. bërjen e aksionarëve/ortakut të shoqërisë që ndahet aksionarë apo ortakë të një ose më shumë shoqërive pritëse, në përputhje me raportin e ndarjes, përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes;
- c. vlerësimin e shoqërisë që ndahet si e prishur dhe çregjistrimin e saj nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, sipas seksionit V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” pa kryerjen e likuidimit.

**Neni 23**  
**Shndërrimi**

Shoqëria mund ta ndryshojë formën e vet ligjore, nëpërmjet shndërrimit te saj në shoqëri aksionare

Shndërrimi nuk sjell pasoja mbi të drejtat e detyrimet, që shoqëria ka marrë përsipër ndaj të tretëve.

**Neni 24**  
**Baza Ligjore**

Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

**Neni 25**  
**Mosmarreveshjet**

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

**Neni 26**  
**Dispozita përfundimtare**

Ky Statut u redaktua ne 3 ekzemplare me vlera te njejta juridike ne gjuhen shqipe dhe nenshkruset me vullnetin e tij te lire nga ortaku themelues.

**ORTAKU I VETËM I SHOQËRISE**

**“BAKUS “ SHPK**

**Laert Gjergji**

